


# Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje

**Tiranë, më 29 Tetor 2021:** Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune gjatë vitit 2021, përfaqësojnë 98,5 % të ndërmarrjeve ekonomike, nga 98,3 % që ishte në vitin 2020.


Të punësuarit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune përbëjnë 27,8 % të të punësuarve gjithsej të ndërmarrjeve, nga 27,2 % që ishte në 2020. Përqindja më e lartë e të punësuarve që përdorin kompjuter vërehet në aktivitetin e informacionit dhe komunikimit me 75,2 %, e ndjekur nga aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 62,7 %.

**Fig. 1 Përqindja e të punësuarve që përdorin kompjuter në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik (%),2021**




Nga ndërmarrjet që përdorin kompjuter për qëllime pune në vitin 2021, 98,4 % e tyre kanë akses në internet nga 98,3 % në vitin 2020. Të punësuarit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune me akses në internet përbëjnë 26,2 % të të punësuarve gjithsej. Në vitin 2021, ndërmarrjet me 250+ të punësuar përdorin 100 % kompjuter me akses në internet. Në këto ndërmarrje, 29,9 % e të punësuarve përdorin kompjuter me akses në internet.

**Fig. 2 Përdorimi i internetit në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2021**




Në vitin 2021, 98,1 % e ndërmarrjeve ka përdorur lidhje fikse në internet, e cila përfshin lidhjet e tipit ADSL, SDSL, VDSL, fibër optike (FTTP), teknologji kablllore, etj. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë patur shpejtësinë e shkarkimit të informacionit më të lartë se 10 Mbit/s është 90,5 % nga 79,8 që ishte në vitin 2020.

**Fig. 3 Shpejtësia maksimale për shkarkim dokumentash (%), 2021**




Faqja e internetit është përdorur nga nga 45,0 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet nga 44,6 % që ishte në vitin 2020. Në vitin 2021, 92,8 % të ndërmarrjeve, faqja e internetit është përdorur për të shfaqur katalogët e produkteve ose çmimet e tyre, 38,3 % e kanë përdorur për marrjen e porosive, rezervimeve apo pronotimeve online dhe 42,2 % e ndërmarrjeve e kanë përdorur për referencë në profilet e medias sociale të tyre.

**Fig. 4 Përqindja e ndërmarrjeve që kanë faqe interneti, sipas aktivitetit ekonomik (%), 2021**



Në vitin 2021, 13,3 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 32,2 %, pasuar nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 29,0 % dhe shërbime administrative dhe mbështetëse me 26,1 %.

**Fig. 5 Shitjet on-line nëpërmjet faqeve të internetit/aplikacioneve sipas aktivitetit ekonomik (%), 2021**



Në vitin 2021, ndarja automatike e informacionit brenda ndërmarrjes, e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionin midis fushave të ndryshme funksionale është përdorur nga 35,8 % e ndërmarrjeve nga 35,1 % që rezultoi në vitin 2020.


Përdorimi i software-it për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM) është përdorur nga 24,8 % e ndërmarrjeve gjatë vitit 2021 nga 22,5 % që rezultoi në vitin 2020.

Shërbimet cloud të cilat i referohen shërbimeve që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj janë përdorur nga 20,7 % e ndërmarrjeve që kanë akses në internet nga 18,2 % që rezultoi në vitin 2020.

Printimi 3D, i cili i referohet përdorimit të printerave të veçantë nga ndërmarrjet ose përdorimi i shërbimeve të printimit 3D të ofruara nga ndërmarrjet e tjera me qëllim krijimin e objekteve fizike tre-dimensionale duke përdorur teknologjinë digjitale, është përdorur nga 6,0 % e ndërmarrjeve gjatë vitit 2021, nga 5,5 % që rezultoi në vitin 2020.

Media sociale (Facebook, LinkedIn, Twitter, Youtube, Twitter, Pinterest etj.) është përdorur nga 69,0 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, nga 66,6 % që ishte në vitin 2020.

**Fig. 6 Përdorimi i medias sociale në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2021**



Interneti i gjërave (pajisje ose sisteme të ndërlidhura, shpesh të quajtura pajisje ose sisteme “të mençura”) është përdorur nga 36,4 % e ndërmarrjeve.

Në vitin 2020, si pasojë e pandemisë COVID-19:

- 27,6 % e ndërmarrjeve rritën numrin e takimeve në distancë të kryera nëpërmjet Skype, Zoom, MS Teams etj.
- 19,2 % e ndërmarrjeve rritën numrin e personave të punësuar që kanë akses në distancë në sistemin e postës elektronike të ndërmarrjes,
- 13,5 % e ndërmarrjeve rritën numrin e personave të punësuar që kanë akses në distancë në sistemet e TIK-ut të ndërmarrjes përveç postës elektronike.

# Metodologjia

INSTAT për matjen e nivelit të treguesve të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka kryer në vitin 2021 vërtetimin mbi “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar.

Termi “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” i referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit. Termi TIK është i ngjashëm me termin Teknologji Informacioni (TI), por fokusohet në teknologjitë e komunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi.

Qëllimi i vërtetimit “Anketa për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” është të mbledhë dhe shpërndajë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Për matjen e përdorimit të TIK, INSTAT ka intervistuar 1,947 ndërmarrje të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

## **Njësia e vërtetimit**

Njësia e vërtetimit është ndërmarrja me 10 e më shumë të punësuar, e rezultuar aktive nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve.

## **Fusha e mbulimit**

Në vërtetim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në nivel seksioni.

Seksionet	Përshkrimi
C	Industri përpunuese
D, E	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtim
G	Tregti me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave dhe motoçikletave
H	Transport dhe magazinim
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit
J	Informacioni dhe Komunikacioni
L	Pasuritë e patundshme
M (Grupet 69-74)	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinarë)
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
S (Grupi 95.1)	Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit

**Metoda e grumbullimit**

Në vitin 2021 grumbullimi i të dhënave është bërë i mundur me metodën CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me anketues me tabletë.

Periodha e referencës për variablat kryesore është koha e mbledhjes së të dhënave, tremujori i parë i vitit 2021. Për pyetjet në lidhje me, Shitje/Blerje online, ERP, CRM, printimin 3D periodha referuese është një vit më parë, viti 2020.

**Përkufizime**

**Kompjuter:** Kompjuterat përfshijnë kompjuterat personalë, tabletët apo pajisje të tjera portabël si Smartphone apo Personal Digital Assistants (PDAs).

**Akses në Internet:** Termi “Akses në Internet” i referohet një lidhjeje të jashtme në Internet përmes një kompanie që operon si Ofrues i Shërbimit në Internet (Internet Service Provider – ISP).

**Website:** Faqja e internetit është një dokument me HyperText. Ekzistenca e një website i ofron ndërmarrjes potencial për një performancë më të mirë, mundësi të reja për prezantimin e ndërmarrjes, produkteve, mundësi për njohje më të madhe dhe në të njëjtën kohë aksesin në tregje të reja dhe për rrjedhojë të ardhura më të larta. Faqet e internetit mund të ketë tekst, lidhjet HyperText, imazhe, video dhe zëra.

**Media Sociale:** Përdorimi i Mediave Sociale si psh: Facebook, Google+, Twitter, YouTube etj. i referohet përdorimit nga ndërmarrja të aplikacioneve që bazohen në teknologjinë e Internetit ose në platforma komunikimi për tu lidhur, krijuar dhe shkëmbyer përmbajtje online, me kliente, furnizues, ose partnerë, jashtë ose brenda ndërmarrjes.

**EDI, tip EDI i mesazheve:** Shkëmbimi elektronik i të dhënave (EDI) i referohet transmetimit të strukturuar të të dhënave ose dokumenteve ndërmjet organizatave ose ndërmarrjeve me anë të mjeteve elektronike. Ai gjithashtu i referohet posaçërisht një familje standardesh (të tipit EDI) dhe mesazheve të tipit EDI të përshtatshme për përpunim të automatizuar.

**Shitjet në Web:** Janë shitjet e bëra nëpërmjet një dyqani në internet (web shop), nëpërmjet formularëve në web në një faqe interneti ose ekstranet, ose aplikacione pavarësisht se si aksesohet në web (kompjuter, laptop, telefon celular etj.).

**Ekstranet:** Një rrjet i mbyllur që përdor protokollet e internetit për të ndarë në mënyrë të sigurtë informacionin e ndërmarrjes me furnitorët, shitësit, klientët ose partnerët e tjerë të biznesit. Mund të marrë formën e një zgjerimi të sigurt të një Intraneti që lejon përdoruesit e jashtëm të kenë akses në disa pjesë të Intranetit të ndërmarrjes.

**Pagesa në internet:** Një pagesë në internet është një transaksion i integruar porosi-pagesë.

**Shërbimet cloud:** I referohen shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj. Cloud Computing është një model për të mundësuar hyrje të kudo gjendur, të përshtatshme, në bazë të kërkesës, në një grup të përbashkët burimesh kompjuterike të konfigurueshme (p.sh. rrjetet, serverat, hapësira ruajtëse, aplikacionet dhe shërbimet) që mund të sigurohen me shpejtësi dhe të lirohen me përpjekje ose shërbim minimal të menaxhimit ose të ndërveprimit të ofruesit.

**Ndarja automatike e informacionit brenda ndërmarrjes:** Një paketë programesh kompjuterike, e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionet midis fushave të ndryshme funksionale (p.sh. kontabilitet, planifikim, prodhim, marketing, etj).

**Software-it CRM:** I referohet çdo aplikacioni software për menaxhimin e informacionit rreth klientëve.

**Printimi 3D:** Përdorimi i printerave të veçantë nga vetë ndërmarrja ose përdorimi i shërbimeve të printimit 3D të ofruara nga ndërmarrjet e tjera për krijimin e objekteve fizike tre-dimensionale duke përdorur teknologjinë digjitale.

**Interneti i Gjërave (IoT):** I referohet pajisjeve ose sistemeve të ndërlidhura, shpesh të quajtura pajisje ose sisteme "të mençura". Ato mbledhin dhe shkëmbejnë të dhëna dhe mund të monitorohen ose kontrollohen në distancë përmes internetit.